

VENDIM
Nr. 86, datë 7.6.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.5.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 Prot., datë 12.5.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “b”, “c” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa “d”);
- Dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);
- Kapitalin financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/7, germa “b”);
- Listën e kontratave aktuale dhe të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike (neni 9, pika 4/7, germa “c”);
- Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4/7, germa “a.1”);
- Nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët (neni 9, pika 4/7, germa “b.1”);
- Kapitalin financiar (*i shprehur në vlera monetare*) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/7, germa “c.1”).

Do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti